

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-189/11**

**Prishtinë  
31 maj 2012**

Në çështjen juridike të

**V.Š.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anetarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/61/2010, (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA49371, KPA49372, KPA49373, KPA49374, KPA49377, KPA49378, KPA49379, KPA49380 dhe KPA49382), të datës 25 shkurt 2010, pas seancës së mbajtur me 31 maj 2011, mori këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Refuzohet ankesa e V.Š. si e pa bazuar.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPCC/D/A/61/2011 i datës 25 shkurt 2010, që referohet për lëndën e regjistruar

me numrat KPA49371, KPA49372, KPA49373, KPA49374, KPA49377, KPA49378, KPA49379, KPA49380 dhe KPA49382.

- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 280 € (dyqind e tetëdhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 29 nëntor 2007, V.Š., duke vepruar si anëtar i familjes së ngushtë në emër të axhës së tij të ndjerë, I.Š. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzim të paautorizuar (shkatërrimin e pyllit) të pronës së mëposhtme:

Numri i ankesës dhe lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-189/11 (KPA49371)	Ngastra nr. 724 në vendin e quajtur “Zmijarnik-On”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 4 më sipërfaqe prej 0 ha 8 ari e 50 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-190/11 (KPA49372)	Ngastra nr. 725 në vendin e quajtur “Zmijarnik-On”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 4 më sipërfaqe prej 0 ha 29 ari e 0 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-191/11 (KPA49373)	Ngastra nr. 824 në vendin e quajtur “Kopljani-Breg”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 3 (ish pyll) më sipërfaqe prej 0 ha 28 ari e 5 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-192/11 (KPA49374)	Ngastra nr. 738 në vendin e quajtur “Kolj.Breg-Susnica”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 3 më sipërfaqe prej 0 ha 22 ari e 26 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-193/11 (KPA49377)	Ngastra nr. 796 në vendin e quajtur “Kolj.Breg-Rainaglava”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 3 (ish pyll) më sipërfaqe prej 0 ha 21 ari e 28 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-194/11 (KPA49378)	Ngastra nr. 795 në vendin e quajtur “Kolj.Breg-Rainaglava”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 4 më sipërfaqe prej 0 ha 12 ari e 77 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-195/11 (KPA49379)	Ngastra nr. 781 në vendin e quajtur “Kolj.Breg-jevt.livad”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 4 më sipërfaqe prej 0 ha 22 ari e 33 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-196/11 (KPA49380)	Ngastra nr. 771 në vendin e quajtur “Kolj.Breg-jevt.livad”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 5 më sipërfaqe prej 1 ha 85 ari e 25 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-197/11 (KPA49382)	Ngastra nr. 776 [e korrigjuar: 770] në vendin e quajtur “Kolj.Breg-jevt.livad”, Leqinë, Skenderaj, kullosë e klasës 5 më sipërfaqe prej 0 ha 37 ari e 5 m <sup>2</sup>

Paraqitësi i kërkesës ka sqaruar se ngastrat i përkisnin axhës së tij të ndjerë I.Š. dhe se ai e kishte trashëguar atë. Ai ka thënë se prona është humbur me 14 qershor 1999.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:

- Kopjen e fletës poseduese nr. 112, të lëshuar me 8 nëntor 1999 nga Zyra Kadastrale për Pasuri të Paluajtshme në Skenderaj, ku ceket se ngastra Nr. 724, 725, 738, 770, 771, 781, 795, 796 dhe 824 kishin qenë në posedim të I.(M.)Š.;
- Certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Komuna e Istogut me 3 dhjetor 1996, ku konfirmohet vdekja e D.Š. (emri i babës M.Š.) me 20 nëntor 1996.

Fleta poseduese ka mundur të verifikohet nga zyrtarët e AKP-së. Me kërkesë të AKP-së, paraqitësi i kërkesës u pajtua që të dorëzojë certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtave pronësore (I.(M.)Š.) dhe autorizimin e trashëgimtarëve të mundshëm. Ai ka shpjeguar se nuk ishte iniciuar ndonjë procedurë trashëgimore. Ndonëse paraqitësit të kërkesës i është dhënë një afat prej tridhjetë ditëve për dorëzim të dokumenteve, së pari me 24 nëntor 2008, me 18 shkurt 2009 dhe përsëri me 3 gusht 2009 (këtë herë ai gjithashtu është informuar se kërkesa do hidhej poshtë nëse nuk do t'i dorëzonte këto dokumente), ai nuk ia ka paraqitur AKP-së dokumentet shtesë por vetëm ka sqaruar se nuk ishte i sigurt se kur I.Š. kishte vdekur. Ai mendonte se kjo kishte ndodhur në vitin 1969.

Me 25 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) hodhi poshtë kërkesën pasi që paraqitësi i kërkesës nuk ishte anëtar i familjes së ngushtë të bartësit të së drejtave pronësore dhe nuk ka dorëzuar autorizimin e tij për të vepruar në emër të bartësit të së drejtave pronësore apo të ndonjë anëtari të familjes së ngushtë të bartësit të së drejtave pronësore me një autorizim të vlefshëm (KPCC/D/A/61/2011, shiko nr. 30).

Vendimi i është dorëzuar vajzës së paraqitësit të ankesës, R.R., me 14 janar 2011.

Më 7 shkurt 2011, paraqitësi i kërkesës (më tutje në tekst 'pala ankuese') ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme.

Për të dëshmuar lidhjen e tij farefisnore me bartësin e së drejtave pronësore, I.Š., ai kishte dorëzuar dokumentet në vijim:

- Certifikatën e vdekjes së I.Š., të lëshuar nga Republika e Serbisë për Komunën e Istogut me 28 janar 2011, që tregon se I.Š. kishte vdekur me 5 mars 1969,
- Certifikatën e lartpërmendur të vdekjes së D.Š., të lëshuar nga Komuna e Istogut me 3 dhjetor 1996,
- Certifikatën e lindjes së V.Š., të lëshuar me 30 gusht 2007 nga Republika e Serbisë për Komunën e Skenderajt, që tregon se V.Š., emri i babës D.Š., ishte lindur me 20 shkurt 1945 në Belicë.

Ankuesi ka sqaruar se I.Š. dhe vëllai i tij D.Š. kishin jetuar së bashku në një bashkësi familjare. Pas vdekjes së tyre, trashëgimia nuk ishte ndarë. Megjithatë, njëri nga trashëgimtarët e D.Š. (shënim i gjykatës: mbase vetë ankuesi, parashtrësia nuk është krejtësisht e qartë) kishte shfrytëzuar një pjesë të pronës pa ndonjë pengesë dhe kufizim deri në vitin 1999.

Ankuesi ka kërkuar që t'i pranohet ankesa, të vendoset prona nën mbrojtjen e AKP-së dhe të nxirret një vendim pozitiv lidhur me këtë kërkesë.

#### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar.

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit ligjor. Vendimi i është dorëzuar ankuesit, i cili është përfaqësuar nga vajza e tij R.R., me 22 qershor 2011. Ankesa është paraqitur në të njëjtën ditë, që është brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve të paraparë me neni 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar.

1. Ankuesi nuk ka të drejtë të përfaqësojë axhën e tij në procedurat para Komisionit dhe Gjykatës Supreme si anëtar i familjes së ngushtë.

Sipas nenit 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, “*në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga anëtar i familjes së ngushtë të atij personi*”. Sipas nenit 1 të UA-së, “*Anëtar i familjes së ngushtë” d. m. th. bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë bashkësisë martesore apo të*

*adoptuar) dhe personat e tjerë të cilët bartësi i të drejtës së pronës është i obliguar t'i mbajë në pajtueshmëri me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta mbajnë bartësin e së drejtës së pronës në pajtueshmëri me ligjin në fuqi". Nipi nuk është në mesin e këtyre personave.*

2. Ankuesi deklaron se është bërë pronar i pronës së kontestueshme.

a. Megjithatë, ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai është trashëgimtar i I.Š.. Ai nuk e ka zhvilluar procedurën e duhur trashëgimore, kështu që nuk është në gjendje të paraqes ndonjë dokument në mbështetje të asaj se është trashëgimtar. Faktet shtesë të paraqitura nga ai (për herë të parë) në Gjykatën Supreme nuk paraqesin dëshmi se pala ankuese është trashëgimtar i I.Š.. Në rastin e tij si trashëgimtar i pretenduar i axhës së tij nuk ka efekt fakti nëse axha i tij dhe babai i tij kishin jetuar në një familje të ngushtë. E njëjta gjë vlen edhe për faktin se një pjesë e pronës ishte shfrytëzuar nga D.Š. (i cili kishte vdekur në vitin 1996) ose nga ndonjëri nga trashëgimtarët e tij deri në vitin 1999. Këto rrethana të pretenduara nuk nënkuptojnë se ankuesi ishte trashëgimtar i I.Š..

b. Gjykata po ashtu nuk gjen se pala ankuese kishte trashëguar ngastrën nga babai i tij, D.Š.. Sipas rrethanave të paraqitura nga paraqitësi i kërkesë, kjo do të ndodhte vetëm në rastin nëse D.Š. kishte trashëguar ngastrën ose kishte fituar pronësinë e ngastrës sipas posedimit faktik. Paraqitësi i kërkesë nuk pretendon shprehimisht se babai i tij e kishte trashëguar ngastrën në fjalë. Paraqitësi i kërkesës po ashtu nuk jep ndonjë fakt nga i cili mund të konkludohet se babai i tij e kishte trashëguar këtë ngastër. Fakti se babai i tij dhe axha i tij kishin jetuar në një familje të përbashkët nuk paraqet dëshmi se D.Š. kishte qenë trashëgimtar i I.Š.. Rrjedhimisht, nuk ka prova se pala ankuese i kishte trashëguar ngastrat nga babai i tij D.Š..

Pala ankuese gjithashtu nuk paraqet fakte të mjaftueshme për të konkluduar se D.Š. e kishte fituar pronësinë me anë të posedimit faktik. Madje edhe nëse D.Š. kishte shfrytëzuar "një pjesë të pronës" në mënyrë të pakontestueshme deri në vdekjen e tij në vitin 1996 (parashtresa e paraqitësit të kërkesë nuk është mjaft e saktë), nuk mund të konkludohet se cila pjesë e pronës Rrjedhimisht, gjykata nuk mund të vërtetojë se D.Š. kishte shfrytëzuar ngastrat e kërkuar, nuk mund të vërtetojë se D.Š. kishte fituar pronësinë e asaj ngastre dhe se pastaj pala ankuese e kishte trashëguar

atë ngastër.

- c. Së fundi, nuk mund të konkludohet se vetë ankuesi kishte fituar pronësinë e ngastrës me anë të posedimit faktik. Siç u përmend me lartë, pjesa e shfrytëzuar e pronës nuk është përshkruar sa duhet për të konkluduar se ankuesi kishte shfrytëzuar pronën nga viti 1969 (viti i vdekjes së I.Š.) deri në vitin 1999.

Për këto arsye, refuzohet si e pabazë ankesa dhe konfirmohet vendimi i KKPK-së për sa i përket kërkesës.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë, siç ceket në kontratën e blerjes, është në mes të € 40.000: € 250 (50 + 0,5% e 40.000).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjykata e konsideron si të përshtatshëm afatin prej 90 ditëve. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës (Neni 47.3 dhe 4 i Ligjit për Shpenzimet Gjyqësore).

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**